



---

STATUTI I INSTITUTIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË  
KULTURORE

MIRATOI

MINISTËR

Elva Margariti



## Tabela e Përbajtjes

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	3
Neni 1 Objekti.....	3
Neni 2 Statusi juridik.....	3
Neni 3 Misioni.....	3
Neni 4 Parimet.....	4
Neni 5 Stema, vula zyrtare dhe logoja.....	4
Neni 6 Selia.....	4
Neni 7 Kohëzgjatja.....	4
KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I IKTK-së.....	4
Neni 8 Organizimi dhe funksionimi.....	5
Neni 9 Struktura organizative.....	5
Neni 10 Detyrat e IKTK-së .....	6
KREU III DREJTIMI, MARRËDHËNIET E PUNESIMIT, DHE DETYRAT E DREJTORIT...8	8
Neni 11 Drejtimi.....	8
Neni 12 Detyrat e Drejtorit .....	8
Neni 13 Punësimi.....	9
KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR.....	9
Neni 14 Të ardhurat buxhetore.....	9
Neni 15 Hartimi i projekt buxhetit.....	10
Neni 16 Auditimi finansiar.....	10
KREU V DISPOZITA TË FUNDIT.....	10
Neni 17 Propozimi dhe Ndryshimet në Statut.....	10
Neni 18 Hyrja në fuqi.....	10

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Objekti**

Ky statut përcakton misionin, organizimin, funksionimin, si dhe parimet bazë mbi të cilat udhëhiqet Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, në vijim IKTK.

#### **Neni 2**

#### **Statusi juridik**

- IKTK krijohet, organizohet dhe funksionon në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, vendimin nr. 364 datë 29.05.2019 e Këshillit të Ministrave “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, urdhrin nr. 137, datë 21.10.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, rregulloren e brendshme të IKTK-së, si dhe me dispozitat e këtij statuti.
- IKTK është institucion kombëtar i specializuar shkencor, me organizim në nivel qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

#### **Neni 3**

#### **Misioni**

- IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.
- IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 4**

#### **Parimet**

IKTK-ja, në veprimtarinë e saj, mbështet dhe përkrah lirinë e informacionit dhe të drejtën e informimit si një e drejtë themelore e qytetarëve dhe siguron qasje të barabartë për të gjithë. IKTK-ja gjithashtu, ushtron veprimtarinë e saj në respektim të parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë, mosdiskriminimit, parimin e mbrojtjes së të dhënave, ruajtjes së konfidencialitetit, deburokratizimit, eficencës, ekonomicitetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë në marrjen e vendimeve dhe profesionalizmit.

**Neni 5**  
**Stema, vula zyrtare dhe logoja**

1. IKTK-ja identifikohet me stemën dhe vulën e saj zyrtare.
2. Stema e IKTK-së përbëhet nga stema e Republikës dhe shënimet: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS, INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vula e IKTK-së, ka formë rrethore ku përcaktohet emërtesa ligjore e institucionit “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS, INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE, TIRANË” dhe stema e Republikës së Shqipërisë.
4. Vula e protokoll/arkivës, ka formë drejtkëndore ku në rreshtin e parë përcaktohet emërtesa e institucionit “INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE”, në rreshtin e dytë përcaktohet “Nr. \_\_\_\_ Prot.” dhe në rreshtin e tretë përcaktohet “Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_.20 \_\_\_\_.”.
5. Vula e sekretarisë, ka formë rrethore ku përcaktohet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE, SEKRETARIA, TIRANË” dhe stema e Republikës së Shqipërisë;
6. Vula e Arkivit Teknik, ka formë rrethore ku përcaktohet “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE, ARKIVA TEKNIKE, TIRANË”.
7. Vula e KKTKM-së, ka formë rrethore ku në rrethin e parë të jashtëm shkruhet: “REPUBLIKA E SHQIPËRISË, MINISTRIA E KULTURËS”; në rrethin e dytë shkruhet: “KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE” dhe “SEKRETARIA TEKNIKE”; në qendër të vulës vendoset stema e Republikës së Shqipërisë.
8. Vula e IKTK-së prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Neni 6**  
**Selia**

IKTK-ja është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë, me adresë: rruga “Aleksandër Moisiu”, nr.76, ish Kinostudio “Shqipëria e Re”.

**Neni 7**  
**Kohëzgjatja**

IKTK-ja është krijuar për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi, si dhe me këtë statut, për një afat kohor të pacaktuar.

**KREU II**  
**ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI I IKTK-së**

**Neni 8**  
**Organizimi dhe funksionimi**

1. IKTK e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe organizohet në nivel qendror.
2. IKTK-ja në përbushje të funksioneve të veta bashkërendon punën me:
  - a) Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK);
  - b) Njësitë e Administrimit dhe të Koordinimit të Parqeve Arkeologjike (NJAKPA);
  - c) institucionet e vetëqeverisjes vendore;
  - d) institucionet e tjera publike në varësi të ministrisë përgjegjëse të trashëgimisë kulturore, organet e administratës qendrore, organet e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera shkencore, kulturore, fetare, persona fizikë e juridikë për evidentimin, gjurmimin, konservimin, studimin dhe restaurimin e pasurive kulturore;
  - e) UNESCO-n, si dhe me organizata të tjera ndërkontaktore në lidhje me trajnimet për formimin profesional dhe specializimin e restauratorëve dhe operatorëve të rinj të trashëgimisë kulturore, pjesë të strukturave shtetërore dhe institacioneve të specializuara për trashëgiminë kulturore;
  - f) institacione të tjera të specializuara të sistemit të Akademisë së Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, si dhe institacione homologe ose organizma ndërkontaktore, në fushën e trashëgimisë kulturore.
3. IKTK-ja drejtohet dhe përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e IKTK-së dhe përgjigjet para ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
4. Struktura dhe organika e IKTK-së miratohet me urdhër të Kryeministrit.

**Neni 9**  
**Struktura organizative**

1. IKTK organizohet dhe funksionon sipas strukturës së miratuar me urdhër të Kryeministrit. Numri i punonjësve, struktura dhe organika propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së dhe dërgohet në organin epror, e cila vazhdon procedurën e mëtejshme të shqyrtimit dhe dërgimit për miratim në Kryeministri.
2. Struktura është e ndërtuar sipas detyrave funksionale dhe përbëhet nga pozicionet administrative, si vijon:
  - a) Drejtori i Përgjithshëm
  - b) Sektori i Sekretarisë Teknike
  - c) Sektori i Arkivës Teknike
  - d) Drejtoria e Monumenteve të Kulturës
    - i. Sektori i Veprave të Artit

- ii. Sektori i Arkitekturës Antiko-Mesjetare
  - iii. Sektori i Qendrave Historike, Arkitektura e Traditës dhe Peizazhit
  - iv. Sektori i Qendrës Rajonale të Konservimit dhe Restaurimit për Evropën Juglindore
  - e) Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik
    - i. Sektori i Shpëtimit Arkeologjik Nëntokësor dhe Nënujor
    - ii. Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Arkeologjike Nëntokësore dhe Nënujore
  - f) Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
  - g) Sektori i Platformës Digitale për Trashëgiminë Kulturore
3. Të drejtat dhe detyrat për Drejtor Drejtorie, Përgjegjës Sektori dhe specialistët në varësi të tyre, përcaktohen hollësishët në Rregulloren e Brendshme të IKTK. Detyrat dhe funksionet e Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe sportelit unik të KTKM-së përcaktohen në Rregulloren e KTKM-së.

### **Neni 10 Detyrat e IKTK-së**

IKTK ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) organizon punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën e:
  - i. trashëgimisë kulturore materiale me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale;
  - ii. arkeologjisë parandaluese e të shpëtimit dhe studimit të trashëgimisë arkeologjike, si rrjedhojë e planifikimit urban e territorial në Republikën e Shqipërisë;
  - iii. pasurive të peizazhit kulturor.
- b) monitoron dhe bashkërendon punën me DRTK-të, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e tyre;
- c) konstaton verifikimin ose jo, të interesit kulturor për pasuritë e paluajtshme sipas procedurave përkatëse në ligjin për trashëgiminë kulturore;
- d) nëpërmjet sekretarisë teknike kryen verifikimet e natyrës teknike dhe siguron nga kërkuesit informacione të tjera shtesë në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, lidhur me kërkesat për ndërhyrje;
- e) vendos pezullimin e menjëhershëm të ndërhyrjeve kur konstaton kryesisht, ose me propozim të institucioneve të specializuara, kryerjen e punimeve në kundërshtim me ligjin;
- f) monitoron ushtrimin e veprimtarisë së subjekteve të licencuara;

- g) kryen formimin e vazhdueshëm të personave të pajisur me licenca në fushën e projektimit e të zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale dhe veprimtarisë arkeologjike;
- h) kryen studime për shtrirjen e zonës së mbrojtur për pasuritë kulturore të paluajtshme ose grupimin e pasurive kulturore të paluajtshme;
- i) vendos masat e mbrojtjes indirekte, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- j) propozon procedurën për kryerjen e hulumtimeve arkeologjike;
- k) koordinon planet e zhvillimit, të projekteve restauruese dhe konservuese, projekteve kërkimore-shkencore të NJAKPA-ve;
- l) ndjek gjetjet rastësore arkeologjike gjatë zbatimit të projekteve zhvillimore ose punimeve të tjera të çfarëdollojshme dhe merr masa për shpëtimin e këtyre vlerave, sipas procedurës së parashikuar në ligj;
- m) nëpërmjet punonjësit të autorizuar pezullon punimet që mund të dëmtojnë vlerat arkeologjike deri në marrjen e një vendimi nga KTKM, në rastin e zbulimeve të rëndësishme;
- n) regjistron njoftimet për gjetjet rastësore detare dhe nëntokësore;
- o) studion dhe përcakton kufijtë e zonave të mbrojtura të pasurive kulturore;
- p) konsulton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore lidhur me hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rjetëzim për vlerat kulturore të paluajtshme;
- q) së bashku me IKRTK-në harton masat për ruajtjen, mbrojtjen, mirëmbajtjen, administrimin, tjetërsimin dhe qarkullimin e objekteve muzeore dhe të koleksioneve muzeore;
- r) kryesisht ose me propozim të institucioneve të specializuara të njësive të qeverisjes qendrore ose të vetëqeverisjes vendore fillon procedurën e vlerësimit, duke verifikuar ekzistencën e interesit të veçantë publik për pasuritë e peizazhit kulturor për pasuritë e paluajtshme dhe për zonat për të cilat është marrë iniciativa;
- s) lëshon lejet e peizazhit kulturor pas miratimit të kërkesës nga KTKM, si dhe i sugjeron KTKM-së vendosjen e distancave, masave/hapësirave dhe variante të projektit në fazë ekzekutimi të nevojshme për ruajtjen e vlerave të peizazhit;
- t) përgatit dhe realizon në mënyrë periodike botime të ndryshme shkencore, albume dhe udhërrëfyes;
- u) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore formon dhe përditëson njohuritë e restauratorëve dhe të subjekteve të licencuara;

- v) nëpërmjet Qendrës Rajonale për Konservim dhe Restaurim të Evropës Juglindore, nën koordinimin e UNESCO-s, harton dhe zbaton programe të kualifikimit të specialistëve në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;
- w) Zbaton detyrimet që rrjedhin në kuadër të Konventës së Trashëgimise Botërore për sitet e trashëgimisë botërore në Shqipëri;
- x) çdo detyrë tjeter të përcaktuar me ligj.

### **KREU III**

#### **DREJTIMI, DETYRAT E DREJTORIT DHE MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT**

##### **Neni 11 Organet Drejtuese**

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative e shkencore në IKTK realizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

##### **Neni 12 Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së emërohet, lirohet dhe/ose shkarkohet nga detyra, nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në përputhje me vendimin nr.173, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave "Për emërimin, lirimin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të ministrit".
2. Drejtori i Përgjithshëm i IKTK-së ka këto përgjegjësi kryesore:
  - a) garanton zbatimin e vendimeve lidhur me politikat e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
  - b) është përgjegjës për hartimin e objektivave dhe zbatimin e planeve strategjike në përputhje me objektivat dhe misionin e IKTK-së;
  - c) monitoron dhe kontrollon faktorët e riskut që venë në rrezik arrijen e objektivave të IKTK-së;
  - d) planifikon, drejton dhe koordinon funksionimin e përgjithshëm të institucionit;
  - e) shpërndan punën brenda institucionit dhe siguron arrijen e rezultateve në kohë dhe me cilësi, sipas objektivave të planifikuar;
  - f) drejton punën administrative e shkencore të IKTK-së;
  - g) përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët dhe raporton për detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe institucionet e tjera;
  - h) mbikëqyr dhe menaxhon efektivitetin e punonjësve dhe ruajtjen e nivelit të tyre profesional;

- i) është Kryetar i Këshillit Teknik dhe Sekretar i Përgjithshëm i KTKM-së në Ministrinë e Kulturës ;
- j) drejton punën administrative të Sekretarisë Teknike të KTKM-së;
- k) jep udhëzime lidhur me trajtimin e kërkesave që i kalojnë për shqyrtim KTKM-së;
- l) emëron dhe shkarkon punonjësit e IKT-së në bazë të legjislacionit të punës dhe Rregullores së brendshme të IKT-së;
- m) ndjek rregullisht proceset administrative dhe merr masa për zgjidhjen e problemeve;
- n) drejton punën në Redaksinë e IKT-së për botimin periodik dhe shkencor “Revista Monumentet” si dhe botime të tjera, albume dhe guida.

### **Neni 13 Punësimi**

1. Punësimin në IKT bëhet me kontratë individuale pune në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës.
2. IKT-ja vundos marrëdhëniet e punës me punonjësit përmes kontratave me kohëzgjatje të pacaktuar ose me afat të caktuar, sipas nevojave administrative institucionale.
3. Rregullimi i marrëdhënieve të punës për sa i përket vlerësimit të performancës, përshkrimit individual të punës, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, shkeljet dhe masat disiplinore, etj., përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të IKT-së.
4. Marrëdhëniet e punës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe punonjësve të IKT-së rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **KREU IV ADMINISTRIMI FINANCIAR**

#### **Neni 14 Të ardhurat buxhetore**

1. IKT është një institucion buxhetor shtetëror në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. IKT në kuadër të realizimit të projekteve për trashëgiminë kulturore, mund të marrë donacione dhe sponsorizime të ndryshme nga subjekte private ose organizata të ligjshme, shqiptare apo edhe të huaja në kuptim të Ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar.
3. Fondi për buxhetin e IKT-së miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, menjëherë pas miratimit nga Kuvendi të ligjit për buxhetin vjetor.
4. Fondet vjetore të akorduara nga buxheti i shtetit dhe çdo e ardhur e realizuar nga sponsorizimet, donacionet etj, do t'i nënshtrohen rregullave të legjislacionit në fuqi.

5. Të ardhurat buxhetore krijohen dhe administrohen nga IKTK-ja sipas Legjislacionit në fuqi, VKM nr. 432 datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe udhëzimeve përkatëse të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

**Neni 15**  
**Hartimi i projekt buxhetit**

IKTK, dy herë gjatë vitit kalendarik, paraqet pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, projekt buxhetin afatmesëm, të shpenzimeve dhe të investimeve për vitin pasardhës, të shoqëruar me preventivat përkatëse.

**Neni 16**  
**Auditimi financiar**

Administrimi dhe veprimtaria financiare e IKTK-së auditohet nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, si dhe institucione të tjera të ngarkuara me ligj, për auditim.

**KREU V**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 17**  
**Propozimi dhe ndryshimet në statut**

1. Statuti i IKTK-së, propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.
2. Ky statut përmirësohet sa herë që praktika e punës dhe ndryshimet në legjislacion e bëjnë të nevojshme një gjë të tillë. Ndryshimet në statut propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Statut hyn në fuqi në datën e miratimit të tij. Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet statuti i miratuar me Urdhër të Ministrit të Kulturës, me nr. 9, datë 23.01.2017.